

VENDIM
Nr. 89/2015

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR
TË KONTROLLUAR ZBATIMIN E LEGJSLACIONIT NË FUQI PËR
ADMINISTRIMIN E BAZAVE TË TË DHËNAVE SHTETËRORE TATIMORE**

Në mbështetje të neneve 7, 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 5, 6, 8 e 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore tatimore, si dhe për të njohur dhe verifikuar në thellësi fenomenin e ndërhyrjeve dhe bllokimit për disa ditë të sistemeve elektronike tatimore, me synim parandalimin e këtij fenomeni negativ për shtetin, qytetarët dhe bizneset dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete.

II. Objekti i punës së komisionit hetimor është:

1. Kontrolli i zbatimit të legjislacionit tatimor në administrimin e bazave të të dhënave shtetërore nga ana e administratës tatimore për periudhën 12.11.2013 – 7.12.2013.

2. Njohja dhe verifikimi i problematikës së ndërhyrjeve në sistemet tatimore, me qëllim përcaktimin e mënyrës së kryerjes së këtij veprimi, si dhe identifikimin e përgjegjësive nga organet apo personat zyrtarë përkatës, me synimin për frenimin me mjete ligjore të shfaqjes së tij në të ardhmen.

3. Njohja me arsyt e mosfunksionimit të sistemeve tatimore për disa ditë, me qëllim parandalimin e kësaj problematike të dëmshme në të ardhmen.

III. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, veçanërisht parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe duke respektuar dhe duke mos mbivendosur kompetencat e organeve të drejtësisë.

IV. Komisioni hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, ndryshime apo miratime ligjesh, me qëllim ndalimin përfundimtar të ndërhyrjeve të paligjshme në sistemet tatimore dhe, sipas rastit, njoftimin e prokurorisë për marrjen e masave të mëtejshme ligjore.

V. Komisioni hetimor parlamentar përbëhet nga 11 deputetë si më poshtë:

- | | | | |
|----|-------------------|-----------------|-------|
| 1. | Arben Ristani | Kryetar | (PD) |
| 2. | Ervin Bushati | Zëvendëskryetar | (PS) |
| 3. | Vasilika Hysi | Anëtare | (PS) |
| 4. | Blerina Gjylameti | Anëtare | (PS) |
| 5. | Ervin Koçi | Anëtar | (PS) |
| 6. | Antoneta Dhim | Anëtare | (PS) |
| 7. | Përparim Spahiu | Anëtar | (LSI) |
| 8. | Jorida Tabaku | Anëtare | (PD) |

9. Florion Mima Anëtar (PD)
10. Helidon Bushati Anëtar (PD)
11. Sherefedin Shehu Anëtar (PD).

VI. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 3-mujor nga data e miratimit të këtij vendimi.

VII. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit që të caktojë menjëherë mjediset dhe mjetet e punës së komisionit, si dhe personelin e nevojshëm, duke vënë në dispozicion edhe ekspertë juristë.

VIII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që, brenda 5 ditëve nga miratimi i këtij vendimi, t'i kalojë komisionit të gjitha aktet, dokumentet apo informacionet e hartuara apo të administruara gjatë veprimtarisë së komisionit hetimor "Për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi për administrimin e bazave të të dhënave shtetërore tatimore, si dhe për të njohur dhe verifikuar në thellësi fenomenin e ndërhyrjes dhe bllokimit për disa ditë të sistemeve elektronike tatimore", të ngritur me vendimin nr.81/2014 të Kuvendit të Shqipërisë.

IX. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të marrë masa për zbatimin e vendimit të Kuvendit dhe të urdhreve të Kryetarit të Kuvendit për mbarëvajtjen e punës së komisionit, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të tij.

X. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 22.10.2015